

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit I. B.(Sh.) nga fsh.S.. K.Vitisë të cilin me autorizim e përfaqëson F. H. nga L..., kundër të paditurit A.B.(Xh) nga fsh.S.. dhe I. B.. D. ish nga fsh K... tani me adrese te panjohur, të cilin e përfaqson përfaqësi i përkohshëm av. M.A... nga Vitia, baza e kontestit vërtetim i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 21.03.2017, shpallë këtë;

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit I. B. (Sh.) nga fsh.S. K.Vitisë dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr. XXXX në sipërfaqe prej XXXXm², në vendin e quajtur “O.. K...”, dhe ngastra e re kadastrale me nr XXXX, me sipërfaqe XXXm² në bazë të ekspertizës së dt.XXXX, në vendin e quajtur “ C. M. O.e ” ZK.XX, të regjistruara në emër të pronarit juridik X. B. (A.) nga fsh.S.. K.Vitisë, dhe ngastra me nr .XXXX me sipërfaqe XXXX në vendin e quajtur “D.” ZK.K., e regjistruar në emër të pronarit juridik I.B. (D.), ish nga fsh.K..., **në bazë të shitblerjes**.

DETYROHEN të paditurit A. B. (Xh.) nga fsh.S. dhe I.B. D. ish nga fsh K..tani me adrese te panjohur, t’ia njohin të drejtën e pronësisë paditësit I. B. (Sh.) nga fsh.S.. K.Vitisë, dhe të durojnë që ngastrat e lartpërmendura të regjistrojnë në emrin e paditësit.

Ky aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

II. Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

A r s y e t i m

Gjykata të paditurit të dytë, I. B. D.. ish nga fsh K... i kishte dërguar përgjigje në padi, por përgjigjja nuk ishte kthyer, sepse të paditurin ishte e pamundur t’i gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, në fletëkethese thuhej se i padituri ishte i panjohur.

Në seancën e datës xxxx përfaqësuesja e paditësit I.. B.. F.. H.. deklaron: Mbetem pranë padisë dhe kërkesë padise dhe kërkoj nga Gjykata që paditësit I.. B. të njihet e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr.xxxx në sipërfaqe prej xxxm². ZK.S..., menjherë pas shitblerjes ka paguar tërë qmimn e shitblerjes dhe ka hyrë në posedim të kesaj palujtëshmerie, si dhe ngastren kadastrale nr.xxxx në sipërfaqe sipas gjendjes faktike në teren ZK.S..kete ngaster gjyshi i të paditurit të parë A. B. në vitet e 60 ja kishte falur babai të paditurit Sh.B. një pjesë të kesaj ngastre rreth 20 ha.

Po ashtu kërkoj nga Gjykata që paditësit të njihet e drejtja e pronësisë në ngastren nr.0930-0 në vendin e quajtur “D.a” në sipërfaqe prej xxxm², ZK.S..., nga se kete ngaster babai ime e ka blerë nga i padituri në vitin xxxx, dhe ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim pa u paguar nga askush.

I padituri i parë A.. B.. (Xh...) deklaron: Nuk e kundërshtoj padijen e as kërkesë padinë nga se është e vërtetë se ngastren nr.xxx-0 ZK.S..., babai ime ja ka shitur babai të paditësit ndërsa saj perkete ngastres se dyte xxxx në vendin e quajtur “ xxx e xxxx” gjyshi ime ja kishte falur babait të paditësit Shefki Beratit sipas gjendjes faktike që është në teren.

I padituri i parë A.. berati deklaron, se une do të marrë pjesë edhe në seance kur gjykata do të del në teren se bashku me eksperte të gjeodezisë ndërsa për seanca tjera nuk do të vijë se nuk kam qka të deklaroj tjetër përpos këtë që e thashe në këtë seance.

Perfaqësuesja e paditesit I. B. F. H... i propozon Gjykates qe te paditurit te dyte ti caktohet një përfaqësues i përkohshem, ku gjykata kishte vendosur duke caktuar përfaqësuesin e përkohshem për të paditurin av. M. A...nga Vitia.

Perfaqësuesja e paditesit I. B. F.H. i propozon gjykatës qe gjykata te caktoj një ekspert te gjeodezisë me qellim te identifikimit të ngastrave nr.xxx xxxx ZK.S.. dhe xxx-0 ZK.K....

Gjykata ka aprovuar propozimin e perfaqësueses se paditësit dhe së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka dalur në vendin e ngjarjes me dt.xxxx, ka berë identifikimin e ngastrave kadastrale nr.xxxx,xxxx dhe xxxxx.

Ngastra nr. xxxxx ZK.Kxxx ne vendin e quajtur Dxxx e cila ngaster për nga gjastësia shtrihet Lindje-perendim, ndërsa per nga gjerësia veri-jug, e cila me kulturë ishte e mbjellur grure.

Ngastra nr. xxxx ZK.Sxxxne vendin e quajtur Oxxx Kxxx Pxxx e cila ngaster për nga gjastësia shtrihet Veri-Jug, ndërsa per nga gjerësia Lindje-perendim, e cila me kulturë ishte e mbjellur bari.

Ngastra nr. xxxx ZK.S.. ne vendin e quajtur Cxxx Mxx Oxxx e cila ngaster ka formen e trekendeshit për nga gjatësia shtrihet Lindje-Perendim, ndërsa per nga gjerësia veri-jug, ne te cilen ngaster eshte e ndertuar nje shtepi, pleme, dhe objekte percjelles, eshte e rrethuar me mure ne te gjitha anet dhe me kulture oborr, e cila do te ndahet sipas gjendjes faktike ne teren.

Ngastra xxxxx u nda ne baze te gjendjes faktike, ku tash paditesi pretendon parcelen e re me nr. xxx me sipërfaqe xxxxm2.

Paditësi dhe perfaqësuesja e paditesit i propozojne Gjykates që për seancën e radhës të ndëgjohen dy dëshmitare qe kane njohuri lidhur me shitblerjen e kësaj ngastre.

Deshmitari L. H. nga S.. deklarone, E di se ngastren katastrale xxxxx e ka bler baba i paditesit I. B..i – Sh.. B... pas luftes prezent une nuk kam qen kur eshte ber pazar por kam ndegjuar nga fqinjet se Sh.B.. e kishte bler ket ngaster , kan hyer ne posedim dhe ne shfrytezim pa u penguar nga sakush , nuk kam ndegjuar qe te jet ankuar dikush qe mos të ju ket paguar qmimi i shtiblerjes sipas marrveshjes gojore .

Dëshmitari I. B. nga fsh. S., ngastren katastrale xxxx baba i paditesit Sh. B..e ka bler nga nje qytetar i njacionalitet shqiptar me duket se nga feja ka qen katolik , e di se e ka paguar ne tersi ka hyr ne posedim dhe shfrytezim pa u penguar nga skush.

Në procedurën e provave gjykata ka: Lexuar Certifikaten e pronese P.xxxxx e dt.xxxxx . ne emer te Xh. . B...i .Kopja e planit e dt.xxxx me numer xxxxx, Kopja e planit e dates xxxx me numer xxxx. Certifikata e prones e dt.xxxxx e dt.xxxx ne emer te I. B. (D) .Kopja e planit e dt.xxxx me numer xxxxx .

Përgjegjja e policijes e dates xxx. Përgjegjja e AKP-se me numer xxxx e dt.xxx. Ekspertiza E dates xxxx për ngastren xxxx . Ekspertiza e dates xxx për ngastren xx Ekspertiza e dates 0xxx për ngastren xxx të perpiluar nga eksperti V..S..

Përfaqësuesja e Paditesi I. B.- F. H. ne fjalën perfundimtare deklarone: Mbetem ne tersi pranë padisë dhe kerkespadisë dhe kërkoj nga gjykata që ti nihet e drejta e pronesisë paditësit x Bxxxne ngastrat katastrale xxx ne vendin e quajtur K.. P. ne sipërfaqe prej xxxx, si dhe në ngastren e re katastrale xxx ne vendin e quajtur S... m.. o. të cilat ngastra ka dëshmuar edhe i padituri A.B. . Xh. ne seancat e me parshme se ngastra numer xxxx është bler nga babi i te paditurit ndersa ngastar me numer xxx e cila eshte ngaster e re tani qe eshte ndar nga ngastar xxx i është falur babi te paditesi I. B.- Sh. B..t nga babi i të paditurit a.a. ..i- Xh.B.. ndersa sa i përket ngastres katastrale xxx besoj qe eshte argumentuar mjaft me daljen e gjykates ne vendin e ngjarjes ndëgjimin e dy dehsmiatreve e këta jan L.. H. dhe I. B. te cilët u ndëgjuan ne ket shyrtim gjyqsor si dhe ekspertiza e ekspertit gjeodet jan

prova te mjaftueshme se ka ekzistuar një raport juridiko civil zingjiron i pa shkruar ne mes te babit te paditësit dhe te paditurit, shka që ka prodhuar efekte juridike për palet nga se paditësi ishte në posedim dhe e shfrytzohte pa u penguar nga askush. andaj kërkohet nga gjykata qe ta aprovoj padin dhe kërkohet padin dhe ti njihet e drejta e pronesi paditesit ne ngastrat e lartpërmenduara

Përfaqesuesi i perkoshem i të paditurit I. B. D. av. M. A.... deklaron: pas mbajtjes se disa seancave gjyqore dhe pas administrimit te provave i propozoj gjykates qe lidhur me kerkesapadin e paditesit I. B. nga fshati S... të vendos në bazë të provave të cilat gjindet ne shkresat e lëndes dhe bindjes se lirë të gjykatës.

Gjykata analizoi thënjet e palëve ndergjygjise, provat e administruara dhe konstatoj: se ngastra katastrale nr. xxxx e evidentuar ne emër të të paditurit te pare Xh... B... që vertetohet ne bazë të qertifikatës së prones me numër xxxxx zona katastrale S., ngastra e dyte e cila u nda ne baze te gjendjes faktike tash me gjendje te re me nr xxxx e evidentuar ne emer te Xh.. B.. në bazë të ekspertizës së dt; ... dhe ngastra me numer xxx e evidentuar ne emer te te paditurit te dyte I. B. (D.) që vertetohet ne bazë të qertifikatës së prones me numër xxx zona katastrale K., këto ngastra I ka blere babai I paditesit, ndersa ngastra xxx I eshte falur babait te paditesit Sh.. B....

Paditësi Is. B.e ka paguar në tersi qmimin e shitblerjës të ngastrave kadastrale, ka hyrë në posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askush ku kjo është vertetua nga deklaratate dëshmitarve si dhe daljës së gjykatës në vendin e ngjarjës, nga keto arsye iu njihet e drejta e pronsisë, paditësit I. B. nga fshati S., si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN -DEGA NE VITI

C.nr. 236/2016

Me 21.03.2017

Sekretare Juridike:
Azize Rama

Gj y q t a r i
Nexhat Aliu

KESHILLA JURIDIKE:Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese, ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes, ne Gjykaten e Apelit ne Prishtinë, përmes kesaj gjykate.